



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

RAPORTI VJETOR

I ADMINISTRATËS SË

SISTEMIT PROKURORIAL

2017



RAPORTI VJETOR I
ADMINISTRATËS SË
SISTEMIT PROKURORIAL
2017

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
1. Informacion i përgjithshëm për administratën e sistemit prokurorial	4
<i>1.1. Administrata e Këshillit Prokurorial të Kosovës</i>	<i>4</i>
1.1.1. Struktura Organizative e SKPK	5
1.1.1.1. Zyra e Drejtorit	5
a) Auditori i Brendshëm	6
b) Zyrtari Certifikues	6
c) Zyra Ligjore	7
d) Zyra për Komunikim me Publikun	7
1.1.1.2. Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë	8
a) Divizioni për Burime Njerëzore	8
b) Divizioni i Prokurimit	9
c) Divizioni i Administratës	10
1.1.1.3. Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	11
a) Divizioni për Buxhet dhe Financa	12
b) Divizioni për Shërbime të Përgjithshme	14
1.1.1.4. Departamenti për Teknologji Informative	15
1.1.1.5. Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHP)	17
a) Zyra për Statistika	18
b) Zyra për mbikëqyrje, analitikë dhe verifikim prokurorial (ZMVP)	19
c) Zyra për trajnime	19

<i>1.2. Administrata e Prokurorit të Shtetit</i>	20
1.2.1. Gjendja aktuale e administratës dhe infrastrukturës në Prokurorin e Shtetit	20
1.2.1.1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit	20
<i>Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave</i>	21
1.2.1.2. Prokuroria e Apelit	22
1.2.1.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës	23
1.2.1.4. Prokuroria Themelore në Prishtinë	24
1.2.1.5. Prokuroria Themelore në Prizren	25
1.2.1.6. Prokurori Themelore në Pejë	25
1.2.1.7. Prokuroria Themelore në Gjiilan	26
1.2.1.8. Prokuroria Themelore në Mitrovicë	28
1.2.1.9. Prokuroria Themelore në Ferizaj	29
1.2.1.10. Prokuroria Themelore në Gjakovë	30
2. Siguria	31
3. Bashkëpunimi	32
4. Trajnimet	32
5. Sfidat	33

Hyrje

1. Informacion i përgjithshëm për administratën e sistemit prokurorial

Administrata e sistemit prokurorial përfshin të gjithë stafin administrativ që punojnë në kuadër të institucionit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të Prokurorit të Shtetit. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sistemin prokurorial është 439, nga të cilët 362 janë Shërbyes Civil dhe 77 janë jo shërbyes civil. Gjatë vitit 2018 janë aprovuar dhe pritët të rekrutohen edhe gjithsej 148 staf administrativ.

1.1. Administrata e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji Nr. 05/L-035) e ka themeluar Sekretariatit e Këshillit për të ndihmuar dhe zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit, lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorive. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore, Sekretariati ishte pjesë e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit. Baza e re ligjore dhe orientimet strategjike të Këshillit kërkojnë riorganizimin e Sekretariatit gjë e cila është mundësuar përmes Rregullores Nr.09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit. Kjo rregullore ka krijuar bazë të fortë për të ngritur nivelin e menaxhimit, administrimit dhe ofrimit efikas të shërbimeve administrative në Këshill dhe Prokurorin e Shtetit. Me rregulloren e Sekretariatit janë të parapara përshkrimet e detyrave për të gjitha pozitat e Sekretariatit.

Rregullorja e Sekretariatit:

- Struktura e qartë organizative
- Përshkrimi i detyrave të punës
- Kontroll – llogaridhënie
- Proaktivitet

Administrata e SKPK përfshin të punësuar në Sekretariat. Struktura organizative e Sekretariatit është: Drejtori i Sekretariatit, departamentet, divizionet dhe zyrat. Sekretariati është i themeluar për të ofruar mbështetje administrative për Këshillin, trupat e Këshillit dhe institucionin e Prokurorit të Shtetit në përgjithësi.

Sekretariati është i vendosur në objektin e Prokurorit të Shtetit, objekt ky i cili nuk është duke i plotësuar nevojat pasi që në të njëjtin objekt është e vendosur edhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Objekti ka një sallë të takimeve e cila është e pajisur me të gjitha pajisjet për përkthim dhe video konferenca.

1.1.1. Struktura Organizative e SKPK

Me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr.09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit e Këshillit, (1 janar 2017), Sekretariati ka adoptuar strukturën e re organizative në pajtim me këtë rregullore si në vijim:

- Zyra e Drejtorit të Sekretariatit:
 - Auditori i brendshëm
 - Zyrtari Certifikues
 - Zyra Ligjore
 - Zyra për Komunikim me Publikun
 - Zyrtrët administrativ
- Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë:
 - Divizioni për Burime Njerëzore
 - Divizioni i Prokurimit
 - Divizioni i Administratës
 - Zyra për Administrim dhe Arkivim
 - Zyra për Përkthim dhe Lektorim
- Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:
 - Divizioni për Buxhet dhe Financa
 - Divizioni për Shërbime të Përgjithshme
 - Zyra për transport
 - Zyra e logjistikës dhe mirëmbajtjes
- Departamenti për Teknologji Informativ:
 - Divizioni për infrastrukturë (rrjet dhe server)
 - Divizioni për sisteme elektronike (softuer).

Gjatë vitit 2017, në Sekretariatit e Këshillit ishin të punësuar 38 staf administrativ. Për vitin 2018 janë aprovuar dhe planifikohet që të rekrutohen 13 staf administrativ në SKPK.

1.1.1.1. Zyra e Drejtorit

Administrata e sistemit prokurorial udhëhiqet nga Drejtori i Sekretariatit si Zyrtari Kryesor Administrativ. Drejtori është përgjegjës ndaj Këshillit për administrimin efikas dhe efektiv të Sekretariatit dhe prokurorive. Drejtori i raporton drejtpërdrejt Kryesuesit

të Këshillit dhe i përgjigjet të gjitha kërkesave të Këshillit për informacion.

Drejtori i Sekretariatit ka udhëhequr procesin e riorganizimit të Sekretariatit pas hyrjes në fuqi të Rregullores, si një nga proceset kryesore që e kanë përcjell Sekretariatit e Këshillit gjatë kësaj periudhe raportuese. Janë kompletuar disa nga pozitat e parapara me rregullore ndërsa pozitat e mbetura parashihen të kompletohen pasi që të aprovohen nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave.

Me qëllim të avancimit të shërbimeve që i ofron administrata e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, janë mbajtur takime të rregullta në mes të udhëheqësve të njësive organizative të SKPK, NJSHPP dhe prokurorive të Kosovës. Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar çështje që kanë qenë me rëndësi për arritjen e qëllimeve të administratës së sistemit prokurorial e që është mbështetja administrative për prokurorët e shtetit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtori i Sekretariatit ka mbajtur takime në baza javore me udhëheqësit e departamenteve të SKPK, ndërsa takime mujore në nivel më të gjërë duke përfshirë udhëheqës të divizioneve dhe administratorë të prokurorive.

Në zyrën e Drejtorit, përveç Drejtorit të SKPK, veprojnë edhe zyrtarët administrativ.

a) Auditori i Brendshëm

Në kuadër të Zyrës së Drejtorit funksionon edhe Auditori i Brendshëm (një Auditor të brendshëm). Auditori i brendshëm gjatë vitit 2017, ka kryer auditime të planifikuara sipas planit vjetor. Këtu përfshihen auditimet e pajtueshmërisë, të cilat kryesisht mbulojnë këto fusha: proceset buxhetore, shpenzimet, të hyrat, paraja e gatshme, menaxhimi i pasurive, të dhënat për pasuritë dhe mirëmbajtja e tyre, prokurimi dhe procedurat e zhvilluara; për punë, furnizime dhe shërbime, auditimi i ZMNV-së, si dhe angazhimi i auditimit në PSRK për të vlerësuar kontrollin e brendshëm. Sipas planit vjetor ishin planifikuar gjithsej pesë auditime dhe janë realizuar të gjitha. Kjo performancë e Auditorit të brendshëm, reflekton në angazhimin sistematik për përmbushjen e objektivave me qëllim të funksionimit të organizatës. Informatat tregojnë se me efikasitet është realizuar niveli i planifikuar.

Për të gjitha të gjeturat, Auditori i brendshëm ka rekomanduar masa organizative për përmirësimin e gjendjes dhe është përcaktuar plotësisht përgjegjësia.

Rekomandimet e dhëna për vitin 2017 janë gjithsej **njëzetekatër (24) rekomandime** nga pesë auditime të përfunduara në fushat e lartcekura. Nga verifikimi i kryer, rezulton që **njëzetë (20) rekomandime** janë zbatuar plotësisht, ndërsa **katër (4) rekomandime** janë në proces të realizimit.

b) Zyrtari Certifikues

Në fillim të vitit 2017, sa i përket certifikimit të lëndëve, obligimet e bartura nga viti 2016 ishin 1,931 lëndë me një shumë prej 330,328.11€. Deri në fund të vitit 2017, janë realizuar

5,434 lëndë me shumë totale 2,137,590.48€. Obligimet e mbetura nga viti 2017 e që janë bartë në vitin 2018 janë 1,274 lëndë me shumë totale 214,010.03€. Gjatë vitit 2017 SKPK ka një Zyrtar Certifikues.

c) Zyra Ligjore

Me hyrjen në fuqi të Rregullores për Sekretariatit është themeluar Zyra Ligjore. Gjatë vitit 2017, kjo zyrë ka zhvilluar aktivitetet si:

- Ofrimin e udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar shërbime efikase dhe cilësore për Këshillin, Komisionet e Këshillit dhe Prokurorin e Shtetit;
- Hartimin e akteve nënligjore nga fushëveprimi i Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit;
- Ka siguruar që vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Përgatitjen e akteve nënligjore në përputhje me ligjin dhe korrigjimet përkatëse ligjore,
- Përcjellja dhe menaxhimi i proceseve të hartimit të akteve nënligjore në Komisionet e Këshillit;
- Këshilla dhe analiza ligjore lidhur me veprimtarinë e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
- Hartimin e shkresave dhe akteve të ndryshme për Drejtorin, përfshirë kontrollin ligjor të vendimeve të njëjësive organizative të Sekretariatit;

Zyra Ligjore ka udhëheqësin e zyrës dhe tre zyrtarë ligjor.

d) Zyra për Komunikim me Publikun

Zyra për Komunikim me Publikun në bashkërendim me Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit ka ofruar informacione në lidhje me çështjet që janë me interes për publikun.

Kjo zyrë është përgjigjur në interesimin e mediave dhe personave tjerë juridik dhe fizik për temat apo proceset që janë në zhvillim e sipër apo që janë zhvilluar në sistemin prokurorial të Kosovës, gjithëherë në koordinim me Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit për çështjet që kanë të bëjnë me rastet që ndiqen nga prokurorët.

Zyra për Komunikim Publik bazuar në monitorimin ditor të mediave nxjerrë statistikën e numrit të informatave me tema të ndryshme të publikuara në të gjitha mediat e ku përmendet sistemi prokurorial (Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit), apo stafi që punon në këtë sistem.

Po ashtu gjatë periudhës raportuese është bërë ridizajnimin i faqes zyrtare të Këshillit, është hartuar draft Strategjia e Komunikimit për sistemin prokurorial, ndërsa Teknologjinë Informativë e ka mbështetur në njoftimin e opinionit dhe target grupeve të caktuara me Projektin TIK/SMIL.

1.1.1.2. *Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë*

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë, sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr. 09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë, aktualisht punojnë 11 staf administrativ.

Ky departament gjatë vitit 2017 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Propozimin e politikave dhe planifikimet përkatëse nga fushë veprimtaria e vet siç janë hartimi i Planit të Rekrutimit; hartimi i Planit të Prokurimit, hartimi i dokumentit të Procedurave Standarde Operative për Burime Njerëzore si dhe Hartimi i Procedurave Standarde Operative për Prokurim;
- Udhëheqjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit vjetor të burimeve njerëzore, prokurimit dhe administratës në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Zbatimin e të gjitha politikave dhe vendimeve të miratuara nga Këshilli dhe Prokurori i Shtetit që përkojnë me fushë veprimtaria e personelit dhe administratës;
- Administrimin dhe menaxhimin në mënyrë efikase dhe efektive të të gjitha aktiviteteve të prokurimit, përfshirë planifikimin dhe strategjitë e tij; dhe
- Menaxhimin me sukses të gjitha dokumentet zyrtare, arkivit dhe aktiviteteve të përkthimit dhe lektorimit.

Departamenti për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë udhëhiqet nga Udhëheqësi i Departamentit dhe ka këtë strukturë organizative:

- a) Divizioni për Burime Njerëzore;
- b) Divizioni për Prokurim, dhe
- c) Divizioni për Administratë, i cili përbehet nga dy zyra:
 - i. Zyra për përkthim dhe lektorim, dhe
 - ii. Zyra për administrimin dhe arkivimin e dokumenteve.

Në vijim do të prezantohen aktivitetet e këtyre tri divizioneve.

a) *Divizioni për Burime Njerëzore*

Divizioni për Burime Njerëzore udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe ka gjithsej 4

zyrtarë të burimeve njerëzore.

Gjatë vitit 2017, Divizioni për Burime Njerëzore, ka rekrutuar 56 staf mbështetës në sistemit prokurorial, nga të cilat 20 pozita të përhershme, 4 pozita me afat të caktuar (zëvendësime), ndërsa në zbatim të Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësi janë sistemuar 30 staf civil dhe 2 staf mbështetës me ligj të punës.

Bazuar në rregulloren nr. 09/2016 janë plotësuar pozitat e Udhëheqësit të Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë, Udhëheqësit të Departamentit për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Sekretariat; Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit, Udhëheqësit për Komunikim me Publikun në ZKPSH.

Ndër të tjera janë rekrutuar edhe pozitat si në vijim: Referent i Lartë, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim profesional, Zyrtar për përkthime dhe Zyrtar Ligjor në gjithë Sistemin Prokurorial të Republikës së Kosovës.

Divizioni ka shqyrtuar dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha kërkesat dhe ankesat që kanë të bëjnë me procesin e rekrutimit, avancimit, transferimit, vlerësimit të performancës dhe disiplinimit.

Divizioni ka shqyrtuar dhe ka dhënë përgjigje në të gjitha kërkesat për avancim të stafit të sistemit prokurorial si dhe ka koordinuar procesin e vlerësimit të performancës së stafit të sistemit prokurorial.

Ka përgatitur dhe proceduar sipas legjislacionit 19 raste të ankesave për rastet e rekrutimit, përgatitur dhe ndihmuar në shqyrtim të 3 rasteve disiplinore.

Divizioni ka bashkëpunuar me Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Financave dhe Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë procesit të planifikimit, rekrutimit dhe shqyrtimit të ankesave. Gjithashtu ka bashkëpunuar me Thesarin lidhur me sistemin e pagave, shtesave dhe ndalesave administrative.

b) Divizioni i Prokurimit

Divizioni i Prokurimit udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit, dhe ka 1 zyrtar të prokurimit.

Gjatë vitit 2017, divizioni i prokurimit ka kryer 5 procedura të prokurimit në vlerë të madhe dhe mesme, 8 procedura me kuotim cmimesh dhe 11 procedura me vlerë minimale.

Kontrata me vlera të mëdha dhe të mesme janë:

- Sigurimi fizik i objekteve të sistemit prokurorial të Kosovës;
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit për menaxhimin e dosjeve të prokurorëve,
- Zhvillimi dhe implementimi i sistemit për menaxhimin e veturave të prokurorëve,
- Furnizimi me Scanner,
- Furnizimi me FIREWALL.

Kuotim i çmimeve janë:

- Furnizimi me dyer për zyrë për objektin e Prokurorisë Speciale,
- Furnizimi me tonera për printera dhe fotokopje për nevoja të KPK-së,
- Furnizimi me material për zyrë,
- Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve,
- Mbajtja e trajnimit të stafit të IT-së të sistemit prokurorial,
- Shërbime të akomodimit, ushqimit dhe pijeve për pjesëmarrësit në trajnime,
- Furnizimi me inventar,
- Shtypja e materialit senzibilizues për javën viktimave të krimit,
- Furnizim me pelet.

Vlerat minimale janë:

- Rregullimi (ndarja me knauf) i shkrimores në PTH Pejë,
- Furnizimi me një kompjuter All In One,
- Furnizimi me roleta veneciane për zyrë,
- Rregullimi i hapësirës gjelbëruese në oborrin e objektit,
- Furnizimi me ujë të pijshëm,
- Furnizimi me rafte,
- Renovimi i dy zyre në PSRK,
- Furnizimi me plaketa me llogon e Këshillit,
- Dizajnimi dhe Montimi i foljeve në murin mbajtës të sallës së takimeve,
- Furnizim me toner Casstte,
- Furnizim me pompë qarkulluese të nxemjes qendrore për nevoja të ngrohjes së objektit.

c) Divizioni i Administratës

Divizioni për Administratë udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe ka 1 zyrtarë të arkivës dhe 2 përkthyes.

Ky divizion aktivitetet e veta i ushtron nga dy zyra:

- Zyra për Administrim dhe Arkivim
- Zyra për Përkthim dhe Lektorim

Gjatë vitit 2017, Zyra për Administrim dhe Arkivim të Dokumenteve ka administruar 9277 shkresa, ndërsa natyra e shkresave të administruara është: rregullore, udhëzime, vendime, fatura, kërkesa, përgjigje dhe shkresa tjera. Gjithashtu, këto shkresa janë sistemuar në folldera klasik, si dhe sistemimin në mënyrë elektronike.

Gjatë vitit 2017, Zyra për Përkthim dhe Lektorim ka koordinuar përkthimet në të gjitha prokuroritë e vendit si dhe ka realizuar përkthime nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas si dhe nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas. Është realizuar përkthimi i 1965 faqe dokumente në gjuhën shqip-serbisht dhe anasjelltas, ndërsa 1222 faqe dokumente në gjuhën shqip-anglisht dhe anasjelltas si dhe rreth 10 ditë pune përkthim simultant në gjuhët shqip serbisht e 10 orë përkthim simultant në gjuhët shqip-anglisht.

1.1.1.3. Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr. 09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të departamentit për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, aktualisht punojnë 14 staf.

Ky departament gjatë vitit 2017 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Propozimin e politikave dhe planifikimin përkatës nga fushë veprimtaria e vet;
- Udhëheqja, koordinimi dhe mbikëqyrja e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve lidhur me buxhetin dhe financat e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;
- Udhëheqja, koordinimi, mbikëqyrja dhe sigurimi i logjistikës së nevojshme për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit;
- Zbatimi i politikave dhe vendimeve të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit që përkojnë me buxhetin, financat dhe shërbimet e përgjithshme dhe
- Administrimi dhe menaxhimi në mënyrë efikase dhe efektive i aseteve, pajisjeve dhe shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.

Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme udhëhiqet nga Udhëheqësi i Departamentit dhe ka këtë strukturë organizative:

- a) Divizionin për Buxhet dhe Financa, dhe
- b) Divizionin për Shërbime të Përgjithshme i cili përbëhet nga:
 - i. Zyra për transport, dhe
 - ii. Zyra e logjistikës dhe mirëmbajtjes

Në vijim do të prezantohen aktivitetet e këtyre dy divizioneve.

a) Divizioni për Buxhet dhe Financa

Divizioni për Buxhet dhe Financa udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe ka gjithsej 5 zyrtarë.

Divizioni për Buxhet dhe Financa ka përgjegjësi kryesore përgatitjen e propozim-buxhetit për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit në bashkëpunim dhe koordinim me të gjitha njësitë organizative, sigurimin e bashkëpunimit të ngushtë me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm në përgatitjen e pasqyrave buxhetore dhe financiare të auditimit, planifikimin dhe koordinimin efektiv mbi financat dhe shpenzimet, përcjelljen dhe zbatimin e instruksioneve, rregulloreve dhe ligjeve mbi menaxhimin e financave dhe mbajtjen e kontakteve me njësitë organizative të Këshillit, Prokurorit të Shtetit dhe me Ministrinë e Financave.

Gjatë vitit 2017, Divizioni për Buxhet dhe Financa ka realizuar aktivitete të ndryshme që lidhen kryesisht me planifikimin e buxhetit, zbatimin dhe kontrollin financiar për gjithë sistemin prokurorial.

Me qëllim të planifikimit të zotimeve bazuar në nevojat e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, është përgatitur dhe zbatuar rrejdha e parasë së gatshme për vitin 2017 për katër programet buxhetore.

Bazuar në nevojat dhe objektivat strategjike të Këshilli është përgatitur Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Kërkesa Buxhetore për vitin 2018, si dhe kërkesat tjera sipas nevojës. Kërkesat nga Këshilli kanë përfshirë rritjen e numrit të personelit administrativ për 148 pozita, rritjen e masës monetare në kategorinë e pagave me vlerë prej 1,817,644.19€, rritjen në kategorinë e mallrave dhe shërbime për 1,014,000.00€, si dhe rritjen në kategorinë e investimeve kapitale për 800,000.00€. Bazuar në Ligjin Nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, Këshillit i janë aprovuar 846 pozita si dhe buxhet vjetor prej 11,092,826.00€, përkatësisht 17.92% më shumë se në vitin 2017.

Gjatë vitit 2017 janë proceduar zotimet dhe shpenzimet për katër programet buxhetore sipas planifikimit.

Për pasqyrim të drejtë dhe shpалosje të shënimeve sqaruese të shpenzimeve për kategoritë ekonomike të buxhetit për katër programet buxhetore është përgatitur raporti vjetor 2017 (pasqyrat financiare 2017) dhe raporti nëntëmujor për vitin 2017.

Raportimet

Bazuar në obligimet të cilat dalin nga Ligji për financa publike si dhe udhëzimit administrativ për raportime të organizatave buxhetore, divizioni për buxhet dhe financa gjatë vitit 2017 ka raportuar në baza mujore për obligimet e krijuara, barazim me ministrin e financave për të gjitha kategoritë në baza tremujore, janë përpiluar dhe dorëzuar pasqyrat financiare për vitin 2016, si dhe është plotësuar dhe dorëzuar pyetësori

i vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2016.

Buxheti i Sistemit Prokurorial

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, Këshillit i janë ndarë 9,483,682.00€, mjete të cilat janë të ndara në katër kategori ekonomike. Gjatë vitit 2017, buxheti fillestar ka ndryshuar me rishikim të buxhetit si dhe me vendime të Këshillit dhe Qeverisë së Kosovës.


Në tabelën nr.1 është paraqitur buxheti fillestar, buxheti përfundimtar si dhe realizimi i buxhetit sipas programeve të Këshillit.

Të gjitha vlerat e paraqitura në tabela dhe grafikone janë në vlerën euro.

Tabela nr.1

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Përfundimtar	Realizimi i buxhetit i shprehur ne vlera	Realizimi i buxhetit i shprehur ne %
Pagat dhe mëditjet	6,600,000	6,300,000	6,049,601	96.03
Mallrat dhe Shërbimet	1,426,552	2,138,313	1,959,450	91.64
Shpenzimet Komunale	199,630	176,630	100,206	56.73
Shpenzimet Kapitale	1,257,500	489,500	75,692	15.46
Totali	9,483,682	9,104,443	8,184,949	89.90

Sipas grafikonit në vijim pasqyrohet realizimi i buxhetit për secilin kategori ekonomike të buxhetit të Këshillit.



b) Divizioni për Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Shërbime të Përgjithshme udhëhiqet nga Udhëheqësi i Divizionit dhe ka 4 zyrtarë dhe 1 shtëpiak (staf mbështetës). Në kuadër të këtij divizioni funksionon Zyra për Transport që udhëhiqet nga Udhëheqësi i Zyrës.

Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme është përgjegjës për koordinimin dhe ofrimin e mbështetjes logjistike për sistemin prokurorial. Ky Divizion bën planifikimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e pasurive jo financiare, materialit shpenzues, automjeteve si dhe ndërtesave të Këshillit.

Gjatë vitit 2017, Divizioni për Shërbime të Përgjithshme ka realizuar aktivitete të ndryshme që lidhen me furnizime dhe shërbime të ndryshme për gjithë sistemin prokurorial.

Procedimi i lëndëve

Ekzekutimi i lëndëve për shërbimet e kryera – Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme në kuadër të së cilës kryhen furnizime dhe shërbime të ndryshme, brenda kësaj periudhe ka ekzekutuar **397 lëndë ekzekutive** të evidentuara në librin intern të Divizionit të Shërbimeve të Përgjithshme. Lëndët janë një sërë aktivitetimesh, duke filluar me furnizime për materiale për zyre, mirëmbajtjen e objekteve, mirëmbajtjen e automjeteve, furnizime me mobile, furnizime me derivate për ngrohje dhe vetura, shërbime tjera kontraktuese, etj.

Ekzekutimi i kërkesave

Përmirësimi i shërbimeve për zhvillimin normal të punëve nga Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme për sistemin prokurorial, ka bërë që të kryhen edhe furnizimet me materiale për zyre, materiale shtypëse, gazeta zyrtare, furnizime me inventar, materiale shtypëse, etj., e që brenda kësaj periudhe, janë kryer **571 kërkesa** (dalje prej sistemi) për furnizime nga depoja qendrore. Furnizimet janë realizuar nga depoja qendrore për prokurorit dhe Sekretariatit e KPK-së.

“E-Pasuria”

Aplikacioni i “E-Pasurisë”, është një aplikacion i cili neve na obligon në bazë të Rregullorës 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare për pasurit nën 1,000 euro. Gjatë kësaj periudhe në Aplikacionin e E-Pasurisë janë regjistruar **31 lëndë** (raporti nga sistemi) që kryesisht kanë të bëjnë me faturat e paguara ndaj Kompanive kontraktuese.

Sistemi për Menaxhimin e Financave “SIMFK”

Në aplikacion e SIMFK-së bëhet regjistrimi i çdo qarkullimi pasuror dhe evidentimi

e secilës pagesë nga Institucionet e Republikës së Kosovës, e po ashtu edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Sa i përket kësaj periudhe raportuese, në kuadër të aktiviteteve të Divizionit të Shërbimeve të Përgjithshme është bërë hyrja e **332 lëndëve** në SIMFK.

Urdhëra të punës

Bazuar në rregulloren e brendshme të punës në Këshillin Prokurorial të Kosovës, në momentin kur paraqitet ndonjë kërkesë për mirëmbajtje ose servisim të veturave, atëherë pas kësaj përgatitet urdhëri i punës me anë të së cilës më pas vetura dërgohet për rregullim tek kompania kontraktuese. Në kuadër të mirëmbajtjes së veturave të sistemit prokurorial të Kosovës, gjatë kësaj periudhe janë lëshuar **371 urdhëra të punës** për mirëmbajtje.

Aktivitetet tjera të veçanta

Gjatë periudhës raportuese është akomoduar PSRK në objektin që është liruar nga personeli i EULEX-it. Është bërë akomodimi i përkohshëm i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, ndërsa në proces të ndërtimi është objekti i Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Është kryer implementimi i donacionit të dhuruar nga Ambasada Amerikane për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit ku përfshihen arkivat dhe pajisje tjera të ndryshme.

Janë zhvilluar procedura dhe specifikacione teknike për realizimin e procedurave tenderuese për menaxhimin e automjeteve, materiale për zyrë, mirëmbajtje të automjeteve, mirëmbajtje të ndërtesave, etj.

Janë kryer procese të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e pasurive jo financiare të sistemit prokurorial si regjistrimi, barkodimi, tjetërsimi dhe inventarizimi i pasurive.

Është përmirësuar sistemi i sigurisë së përgjithshme në sistemin prokurorial, duke i angazhuar në orarin e paradites personelin e Policisë së Kosovës nëpër objektet e Prokurorive dhe Sekretariatit.

Është bërë inspektimi i vazhdueshëm ditor për objektin e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit, ku janë realizuar mbi 1238 intervenime të ndryshme që lidhen me mirëmbajtjen teknike të objektit.

1.1.1.4. Departamenti për Teknologji Informative

Departamenti për Teknologji Informative, sipas mandatit të përcaktuar në Rregulloren Nr. 09/2016 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Këshillit, është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Sekretariatit. Në kuadër të këtij Departamenti, aktualisht punojnë 4 staf administrativ.

Departamenti për Teknologji Informative udhëhiqet nga Udhëheqësi i Departamentit dhe ka këtë strukturë organizative:

- a) Divizioni për infrastrukturë (rrjet dhe server), dhe
- b) Divizioni për sisteme elektronike (softuer).

Ky departament gjatë vitit 2017 ka realizuar aktivitetet si në vijim:

- Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL)
- Sistemi elektronik për menaxhim të veturave
- Sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve të prokuroreve

Infrastruktura e TIK-ut

Aktivitetet tjera të cilat janë realizuar në kuadër të Projektit TIK/SMIL:

- Është ndërtuar qendra e të dhënave në Pallatin e Drejtësisë sipas standardeve bashkëkohore për dhoma të serverëve. Kjo qendër e të dhënave do të mundësojë që të gjitha sistemet elektronike të jenë të qasshme për stafin e prokuroreve.
- Është nënshkruar kontrata për komponentën B - LAN/WAN – Avancimi i infrastrukturës së rrjetit, në kuadër të kësaj komponente përfshihet furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të rrjetit për sistemin prokurorial. Me anë të kësaj komponente do të mundësohet që të kemi një rrjet kompjuterike plotësisht funksionale, stabile dhe më të sigurt.

Në kuadër të donacioneve të Ambasadës Amerikane janë realizuar aktivitetet:

- Furnizim dhe instalim të pajisjeve simultante

Prokuroria Themelore Prishtinë	Kabinë Përkthimi
Prokuroria Themelore Gjilan	Pajisjet Simultante + Kabina për Përkthim
Prokuroria Themelore Pejë	Pajisjet Simultante + Kabina për Përkthim
Prokuroria Themelore Ferizaj	Pajisjet Simultante + Kabina për Përkthim
Prokuroria Themelore Prizren	Pajisjet Simultante + Kabina për Përkthim
Prokuroria Speciale	Pajisjet Simultante + Kabina për Përkthim

- Furnizimi dhe montimi i kabinave metalike lëvizëse për arkiv të prokurorive themelore në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë dhe Ferizaj.



- Furnizimet me pajisje të TI-së të cilat janë bërë nga Departamenti i TI-së, sipas prokurorive:

Prokuroritë	Kompjuter	Printer	Fotokopje
Prokuroria Themelore Prishtinë	9	7	4
Prokuroria Themelore Prizren	13	5	1
Prokuroria Themelore Gjiilan	8		1
Prokuroria Themelore Pejë	2	3	1
Prokuroria Themelore Ferizaj	8	8	
Prokuroria Themelore Mitrovicë	16	10	1
Prokuroria Themelore Gjakovë		4	1
Totali	56	37	9

1.1.1.5. Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHPP)

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive, duke u mbështetur në kompetencat ligjore në mbështetje të Këshillit, gjatë vitit 2017 aktivitetet i ka zhvilluar në kuadër të tri zyrave:

- Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial
- Zyra e Statistika dhe
- Zyra e Trajnimeve

Aktualisht në kuadër të Njësitet janë të punësuar 12 staf administrativ. Gjatë periudhës raportuese pozita e Drejtorit të NJSHPP ishte e lirë, mirëpo Drejtori i Sekretariatit, me vendim të Këshillit ishte caktuar ushtrues detyre i Drejtorit të NJSHPP, deri në zgjedhjen e drejtorit të këtij njësi. Për vitin 2018 janë aprovuar dhe planifikohet të rekrutohen edhe 2 staf administrativ në Njësit.

Njësi është vendosur në objektin e njëjtë ku është Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Më poshtë pasqyrohen aktivitetet e zyrave të NJSHPP.

a) Zyra për Statistika

Struktura organizative e Zyrës së Statistikave është si në vijim: Menaxher i Zyrës dhe dy zyrtarë: Zyrtari i Lartë për Baza të Shënimeve dhe Zyrtari i Lartë për Statistikë dhe Analiza

Aktivitetet të cilat Zyra për Statistika (ZS) i ka përfunduar gjatë kësaj periudhe, janë të bazuara në mandatin e ZS-së, dhe janë të pasqyruara në objektivat dhe aktivitetet, sipas Planit të punës.

Funksionimi i bazave të shënimeve: kriMKorr, PP1, PP2 dhe PPM. Për arritjen e këtij objekti, Zyra për Statistika gjatë kësaj periudhe ka kryer punët si në vijim:

- Monitorimin e vazhdueshëm të përdorimit të Bazave; Monitorimin e kualitetit të të dhënave të regjistruara në këto baza;
- Modifikimi i Aplikacionit të bazës së shënimeve kriMKorr, duke i shtuar fushatë që kanë të bëjnë me veprat penale të Korrupsionit e që ndërlidhen me Prokurim dhe funksionet e personave të dyshuar që ndërlidhen me këto vepra penale, me qëllim të raportimit të KPK-së për MSA.
- Organizimi dhe mbajtja e dy trajnime-punëtori me shefat e shkrimoreve të prokurorive themelore dhe Prokurorisë Speciale, për përdorimin e bazës së modifikuar dhe gjenerimin e raporteve statistikore nga kjo Bazë.
- Me qëllim të përmirësimit të saktësisë dhe ngritjes së nivelit të kualitetit të shënimeve statistikore, ZS së bashku me DTI, zyrave të prokurorëve të Njësitet kundër Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike (Njësitet), të PTh të Prishtinës, iu ka mundësuar kyqjen në Aplikacionin #ebkriMKorr, për të regjistruar të dhëna drejtpërdrejt në këtë Aplikacion. Për funksionalizimin-përdorimin e këtij

Aplikacioni, ZS ka organizuar një trajnim një ditor në Grup me të gjithë zyrtarët ligjor dhe dy ditë trajnim me secilin zyrtar ligjor veç e veç, një me një, deri në aftësimin e plotë për përdorimin e këtij aplikacioni.

- ZS ka bërë identifikimin dhe ka zgjidhur problemet e shfaqura gjatë përdorimit të Aplikacioni të bazës së të dhënave PPI, në Prokurorinë Themelore të Pejës.

b) Zyra për mbikëqyrje, analitikë dhe verifikim prokurorial (ZMVP)

ZMVP zhvillon aktivitete përmes të cilave ofron mbështetje dhe i raporton KPK-së për rrjedhën e proceseve të rekrutimit, avancimit dhe transferimit të prokurorëve të shtetit, punën e prokurorëve duke përfshirë ngarkesën me lëndë dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, përgatitjet e raporteve të ndryshme periodike për punën e prokurorëve si dhe raportin ndër-institucional të mekanizmit përcjellës lidhur me 8 (tetë) grupe të veprave penale karakteristike.

Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial ka ofruar mbështetje të vazhdueshme në proceset e vlerësimit të performancës së prokurorëve, rekrutimit të prokurorëve duke përfshirë edhe procesin e rishqyrtimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve, si dhe mbështetje për komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe komisionin Mbikqyrës për Korrupsion dhe Krime ekonomike.

ZMVP menaxhon me dosjet e prokurorëve dhe gjatë kësaj periudhe bërë përditësimin e dosjeve të prokurorëve, përfshirë databazën për të dhënat e tyre dhe ka hartuar planin e veprimit për procesin e rekrutimit të prokurorëve.

Gjatë periudhës raportuese Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial gjatë vitit 2017 ka hartuar raporte periodike (3, 6, 9 dhe vjetore), si në vijim:

- Raporte të mekanizmit përcjellës ndër-institucional për harmonizimin e statistikave në mes institucioneve;
- Raporte për punën e prokurorisë së shtetit;
- Raporte analitike dhe krahasimore (2014-2016);
- Raporti hulumtues për ngarkesën me lëndë për veprat penale karakteristike (2014-2016);
- Raporti i gjeografisë kriminale (2014-2016).

c) Zyra për trajnime

Gjatë vitit 2017, Zyra për Trajnime në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe partnerë të tjerë, ka koordinuar aktivitetet lidhur me ngritjen profesionale të prokurorëve dhe stafit administrativ.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë gjithsej 581 prokurorë (pjesëmarrës). Ndërsa, në

cilësinë e trajnuesve ishin të angazhuar gjithsej 17 prokurorë.

Për trajnimin e prokurorëve dhe stafit mbështetës, zyra për trajnime ka koordinuar punën me këto institucione: Akademia e Drejtësisë, ICITAP dhe OPDAT programe të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Komisioni Evropian (tre projekte), EULEX, OSBE, UNDP, etj.

Zyra po ashtu ka organizuar edhe trajnime për stafin mbështetës në sistemin prokurorial. Në këto trajnime janë trajtuar 38 tema të ndryshme dhe në to kanë marr pjesë gjithsej 251 zyrtarë (pjesëmarrës).

Gjithashtu zyra për trajnime, ka hartuar raporte të rregullta periodike dhe vjetore për pjesëmarrje në trajnime të prokurorëve dhe stafit mbështetës të sistemit prokurorial. Po ashtu, sipas kërkesave të veçanta, zyra ka përgatitur raporte për të mbështetur Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, si dhe për nevoja individuale ose grupore për të dëshmuar pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnime për tema të caktuara.

1.2. Administrata e Prokurorit të Shtetit

Administrata e Prokurorit të Shtetit përbëhet nga të gjithë të punësuarit në Prokurorin e Shtetit, përfshirë stafin në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe shtatë prokuroritë themelore.

1.2.1. Gjendja aktuale e administratës dhe infrastrukturës në Prokurorin e Shtetit

Në vijim do të prezentohet për secilën prokurori numri i stafit aktual, numri i stafit në proces të rekrutimit dhe infrastruktura.

1.2.1.1. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit veprojnë 6 prokurorë së bashku me Kryeprokurorin e Shtetit. Staf administrativ që shërbejnë në këtë zyrë janë gjithsej 19 të punësuar, si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Kabinetit	1	
Shef i Protokollit		1
Bashkëpunëtor Profesional	1	3
Këshilltar		3
Zyrtar Ligjor	4	1
Asistent financiar	1	
Referent	3	
Zyrtar për komunikim me media	1	1
Zyrtarë të IT-së – Njësia Ndërlidhëse		2
Zyrtar të Arkivist	1	
Dorëzues	1	
Vozitës	2	1
Receptionisti	1	
Asistent i lartë ekzekutiv		1
Asistent administrativ	1	
Asistent i ish kryeprokurorit	1	
Total	19	13

Siç dihet, Këshilli dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit janë të vendosur në një objekt i cili ka mungesë të hapësirës së nevojshme për stafin e dy institucioneve, megjithatë po bëhen përpjeke për sigurimin e mjeteve për ndërtimin e objektit të ZKPSH dhe KPK.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit vepron Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave. Kjo zyrë vepron në shtatë rajonet e vendit ku veprojnë edhe shtatë prokurori themelore.

Stafi i ZMNV-se përbëhet nga Zyra e Menaxherit (Zyra Qendrore), Zyra e Linjës Ndihmëse dhe 7 zyra regjionale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. ZMNV aktualisht ka të punësuar 33 staf nga 37 sa janë të aprovuar.

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Menaxheri i Zyrës	1	
Mbikqyrës i zyrës regjionale	5	
Mbrojtës i Viktimave	17	2
Zyrtar i Veprimeve	1	
Asistent Ekzekutiv	1	
Operatore e Linjës Ndihmëse	1	1
Vozitës	7	
Total	33	3

ZMNV është e vendosur në Pallatin e Drejtësisë, në objektin C.

Zyra Qendrore e ZMNV-së është ballafaquar me sfida të ndryshme në plotësimin e kërkesave dhe përmirësimin e kushteve të stafit i cili punon në operativ (kujdestari pasive 24 orë), avancimi i pozitës (gradës së pagesës) për stafin profesional (mbrojtësit e viktimave), regjistrimi i pasurive jo-financiare, pajisja me kompjuter, fotokopje dhe automjete të reja. Një ndër sfidat mbetet plotësimi i pozitave të lira.

1.2.1.2. Prokuroria e Apelit

Prokuroria e Apelit ka 7 prokurorë dhe 16 staf administrativ, sipas të dhënave si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Bashkëpunëtor Profesional	2	
Sekretare Juridike	2	
Udhëheqës i shkrimore	0	1
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Referent	2	
Asistent administrativ	5	
Arkivist	1	
Përkthyes	1	
Vozitës	1	
Dorëzues	1	
Total	16	2

Prokuroria e Apelit është e vendosur në Pallatin e Drejtësisë në objektin C. Objekti ka hapësira të nevojshme për prokurorët dhe stafin që punojnë në këtë prokurori.

1.2.1.3. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Në kuadër të PRSK-së veprojnë gjithsej 14 prokurorë. Staf administrativ aktualisht janë 37 pozita të plotësuara dhe atë të specifikuara si më poshtë:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	1	7
Ekspert	4	
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	9	5
Sekretare Juridike	8	
Referent	3	
Zyrtar i IT	1	
Teknik i IT	1	
Arkivist	1	
Zyrtar për informim	1	
Përkthyes	2	1
Vozitës	2	1
Shtëpiaku	1	
Total	37	14

PSRK është e vendosur në objektin ku veprojnë edhe prokurorët e EULEX-it në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit në mes të EULEX dhe Këshillit, me të cilin është mundësuar që PSRK të vendoset në këtë objekt. Objekti ku është i vendosur PSRK është mirë i pajisur me të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për punë, por ka mungesë të hapësirave të nevojshme për numrin e planifikuar të prokurorëve dhe stafit. Me ndryshimet eventuale rreth misionit të EULEX, hapësirat e ndërtesës do të jenë të mjaftueshme.

Si sfida për këtë prokurori përveç objektit është edhe mos kompletimi i 18 pozitave të parapara për prokurorë dhe pozitave tjera për staf administrativ të cilat pritet të rekrutohen gjatë vitit 2018.

1.2.1.4. Prokuroria Themelore në Prishtinë

Prokuroria Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2017 kishte 56 prokurorë dhe 83 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohet edhe 1 prokuror që fillon punën në janar 2018. Gjendja e personelit administrativ në këtë prokurori është si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	3	14
Zyrtar Financiar	1	1
Zyrtar Ligjor	29	10
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Zyrtar i IT-së	0	1
Sekretare Juridike	21	
Referent	11	1
Arkivist	5	
Dorëzues	3	
Vozitës	4	1
Përkthyes	2	1
Shtëpiaku	0	
Receptionisti	1	
Pastrues	1	
Total	83	30

Prokuroria Themelore në Prishtinë është e vendosur në Pallatin e Drejtësisë në objektin C. Edhe pse është një objekt i ri, ka mungesë të hapësirave të nevojshme për të gjithë stafin aktual, por probleme do të shfaqen në momentin e plotësimit të të gjitha pozitave të parapara për prokurorë dhe staf administrativ. Megjithatë, është bërë një plan për sigurimin e zyrave të nevojshme për prokurorë dhe stafin i cili do të rekrutohet gjatë vitit 2018. Objekti ka të gjitha sallat e takimeve të pajisura mirë dhe sallën e konferencave e kompletuar me pajisjet të nevojshme përfshirë ato për përkthim. Në këtë objekt janë vendosur raftet lëvizëse të arkivës moderne dhe mjaft praktike.

1.2.1.5. Prokuroria Themelore në Prizren

Prokuroria Themelore në Prizren gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 19 prokurorë dhe 45 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohen edhe 5 prokurorë që fillojnë punën në janar 2018. Gjendja e personelit administrativ të kësaj prokurorie është si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimore	1	
Bashkëpunëtor profesional	1	8
Zyrtar Financiar	2	
Zyrtar për informim	0	1
Zyrtar Ligjor	1	9
Sekretare Juridike	16	
Zyrtar i IT	1	
Përkthyes	1	
Referent	5	
Arkivist	3	
Dorëzues	2	
Vozitës	3	1
Shtëpiaku	1	
Receptionisti	1	
Sigurim	4	
Pastrues	2	
Total	45	19

Prokuroria Themelore në Prizren është e vendosur në objekt të ri i cili i plotëson nevojat e kësaj prokurorie, megjithatë në objektin aktual janë shfaqur disa të meta të cilat planifikohet të eliminohen gjatë vitit 2018. Objekti ka sallë të konferencave të pajisur me pajisjet e përkthimit dhe gjithashtu është i pajisur me raftet lëvizëse të arkivës.

1.2.1.6. Prokurori Themelore në Pejë

Prokuroria Themelore në Pejë gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 13 prokurorë dhe 38 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohen edhe 6 prokurorë që fillojnë punën në janar 2018. Kjo prokurori kishte kapacitetet administrative si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimore	1	
Bashkëpunëtor profesional	0	6
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	7	4
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Sekretare Juridike	10	
Zyrtar i IT	1	
Përkthyes	0	1
Referent	4	1
Arkivist	3	
Dorëzues	2	
Vozitës	3	
Shtëpiak	1	
Receptionist	1	
Sigurim	2	
Pastrues	1	
Total	38	13

Prokuroria Themelore në Pejë është e vendosur në objekt të ri dhe gjatë vitit 2017, me kërkesë të Kryeprokurorit të kësaj prokurorie është bërë një riorganizim dhe janë krijuar hapësira më të përshtatshme për punë me palë. Objekti ka hapësira të mjaftueshme për prokurorët dhe stafin administrativ që shërbejnë në këtë prokurori, ka sallë të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme për përkthim si dhe raftet lëvizëse të arkivës.

1.2.1.7. *Prokuroria Themelore në Gjiilan*

Prokuroria Themelore në Gjiilan gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 17 prokurorë dhe 43 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohet edhe 1 prokuror që fillon punën në janar 2018. Gjendja e personelit në këtë prokurori duket si në vijim:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	3	2
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	5	
Sekretare Juridike	12	
Zyrtar i IT	1	
Referent	6	
Arkivist	3	
Dorëzues	3	
Vozitës	3	1
Përkthyes	2	
Shtëpiak	1	
Receptionist	1	
Pastrues	1	
Total	43	4

Prokuroria Themelore në Gjilan është e vendosur në objekt të ri i cili i plotëson nevojat e kësaj prokurorie. Po ashtu ky objekt ka sallë të takimeve të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme dhe arkivën e re.

1.2.1.8. Prokuroria Themelore në Mitrovicë

Prokuroria Themelore në Mitrovicë gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 20 prokurorë dhe 55 staf administrativ me kapacitetet si më poshtë:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Zv. Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	1	6
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	4	1
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Sekretare Juridike	22	
Zyrtar i IT	2	
Përkthyes	1	4
Referent	7	
Arkivist	5	
Dorëzues	3	
Vozitës	4	
Receptionist	0	
Shtëpiak	0	1
Pastrues	2	
Total	55	13

Gjatë vitit 2017 në këtë prokurori janë rekrutuar 13 prokurorë dhe 32 pozita për stafin nga komuniteti serb si pjesë e Marrëveshjes së Brukselit për Drejtësi.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë është e vendosur në objekt të ri në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë i cili i plotëson të gjitha nevojat e prokurorëve dhe stafit që punojnë në këtë prokurori.

1.2.1.9. Prokuroria Themelore në Ferizaj

Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 13 prokurorë dhe 33 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohen edhe 6 prokurorë që fillojnë punën në janar 2018. Gjendja e personelit në këtë prokurori është si më poshtë:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	0	6
Zyrtar për informim	0	1
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	7	7
Sekretare Juridike	6	
Zyrtar i IT	1	
Përkthyes	1	
Referent	5	
Arkivist	3	
Dorëzues	2	
Vozitës	2	1
Shtëpiaku	1	
Receptionist	1	
Pastrues	1	
Sigurim	0	
Total	33	15

Prokuroria Themelore në Ferizaj është e vendosur në objektin e ri i cili i plotëson kushtet për prokurorë dhe stafin administrativ. Në këtë prokurori ekziston salla e takimeve me të gjitha pajisjet e po ashtu, kjo prokurori ka edhe arkivën e re dhe skanerin e sigurisë.

1.2.1.10. Prokuroria Themelore në Gjakovë

Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë vitit 2017 kishte gjithsej 12 prokurorë dhe 29 staf administrativ. Me procesin e rekrutimit të prokurorëve të vitit 2017 kësaj prokurorie i shtohen edhe 2 prokurorë që fillojnë punën në janar 2018. Gjendja e personelit administrativ në këtë prokurori është si më poshtë:

Pozitat	Numri aktual	Në proces të rekrutimit
Administrator	1	
Shef i Shkrimores	1	
Bashkëpunëtor profesional	0	4
Zyrtar Financiar	1	
Zyrtar Ligjor	7	2
Zyrtar për komunikim me media	0	1
Sekretare Juridike	4	
Zyrtar i IT	1	
Përkthyes	1	
Referent	4	
Arkivist	2	
Dorëzues	2	
Vozitës	1	1
Shtëpiaku	1	
Receptionist	0	
Sigurim	1	
Pastrues	1	
Total	29	8

Prokuroria Themelore në Gjakovë është e vendosur në një objekt privat me qira. Objekti ka mungesë të hapësirave për nevojat e prokurorëve dhe stafit që punojnë në këtë prokurori. Megjithatë, është duke u ndërtuar objekti i ri i kësaj prokurorie dhe pretet që gjatë vitit 2018 ky objekt të funksionalizohet dhe të pajiset me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.

2. Siguria

Ofrimi i sigurisë për prokurorët dhe stafin që punojnë në kuadër të sistemit prokurorial të Kosovës ka qenë një sfidë edhe për vitin 2017, duke pasur parasysh kompleksitetin e punës së sistemit prokurorial.

Administrata ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të ofruar siguri maksimale për të gjithë personat që punojnë në sistemin prokurorial. Si rezultat, me 5 prill 2017, është nënshkruar marrëveshje mes Këshillit dhe Policisë së Kosovës me qëllim të mbajtjes së rendit dhe sigurisë brenda objekteve të prokurorive themelore, Prokurorisë së Apelit dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ndërsa në Prokurorinë Speciale siguria ofrohet nga policia sipas një marrëveshjeje në mes Policisë së Kosovës dhe EULEX-it.

Në bazë të marrëveshjes, pjesëtarët e Policisë së Kosovës do të ofrojnë shërbimet e tyre çdo ditë nga ora 08:00 deri në ora 16:00, nga e hëna deri të premten, duke përfshirë edhe ditët e festave zyrtare, përveç Prokurorisë Themelore në Prishtinë e cila sigurohet 24 orë në ditë.

Angazhimi i pjesëtarëve të policisë bëhet jashtë orarit të rregullt të punës policore, ata janë të pajisur me uniformën policore si dhe i përmbahen ligjit të policisë, udhëzimeve administrative dhe akteve tjera nënligjore të Policisë së Kosovës.

Përveç sigurisë që ofron Policia e Kosovës, njësia përkatëse organizative Sekretariatit ka nënshkruar kontratë me një kompani private të sigurimit e cila ofron siguri për objektet e sistemit prokurorial pas përfundimit të orarit të punës, pra nga ora 16:00 deri në ora 08:00 në mëngjes.

Megjithatë në Prokurorinë Themelore në Prizren, Prokurorinë Themelore në Pejë dhe Prokurorinë Themelore në Gjakovë kemi të punësuar disa roje të sigurimit të cilët janë pjesë e administratës së këtyre prokurorive. Sipas vlerësimeve tona ky lloj personeli ofron siguri dhe shërbime më të mira se ajo që ofrohet nga kompanitë private.

Sipas planifikimeve të fundit për vitin 2018 është përcaktuar si objektivë avancimi i sistemit të sigurisë në sistemin prokurorial, prandaj me kërkesat buxhetore për të ardhmen dhe me KASH për vitin 2019-2021 është kërkuar shtimi i numrit të personelit të sigurimit për të gjitha prokuroritë me qëllim të rritjes së nivelit të sigurisë.

3. Bashkëpunimi

Administrata e sistemit prokurorial të Kosovës ka pasur bashkëpunim të ngusht me institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare që mbështesin punën e sistemit prokurorial të Kosovës.

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare si Ambasada Amerikane, Zyra e BE-së (projekte të ndryshme), EULEX, UNDP, OSCE, si dhe institucione të tjera që në vazhdimësi ofrojnë mbështetje për administratën e sistemit prokurorial por edhe vetë sistemit në përgjithësi.

Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtarë është realizuar nëpërmjet takimeve, trajnimeve dhe vizitave studimore që i ka realizuar personeli administrativ i Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Gjatë periudhës raportuese është duke u realizuar projekti i binjakëzimit mes Këshillit dhe projektit Italiono Francez, projekt ky që po realizohet kryesisht nëpërmjet trajnimeve javore që ekspertët e projektit ofrojnë për prokurorët por edhe administratën në përgjithësi. Një bashkëpunim i cili pritet të jep rezultate pozitive në avancimin e shërbimeve të administratës është ai me Akademinë e Drejtësisë e cila ka planifikuar një seri të trajnimeve për personelin administrativ të sistemit prokurorial.

4. Trajnimet

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit administrativ të sistemit prokurorial për vitin 2017, është hartuar dokumenti nga Sekretariati me të cilin i është propozuar Akademisë së Drejtësisë që në kuadër të kompetencave të saj ligjore gjatë vitit 2017 të mbështetë propozimin për trajnimin personelit administrativ.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur trajnime nga vet Sekretariati për administratën e sistemit prokurorial por edhe trajnime nga Akademia e Drejtësisë.

5. Sfidat

Sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar administrata e sistemit prokurorial gjatë vitit 2017 janë:

- Mungesa e vazhdueshme e buxhetit;
- Statusi i administratës së sistemit prokurorial i cili nuk është reflektuar në katalogun e aprovuar për shërbyesit civil.
- Procedurat e tejzgjatura dhe barrierat për rekrutimin e stafit të ri dhe zëvendësimet e tyre sipas nevojave (kërkesat në MF, procedurat lidhur me MAP dhe procedurat lidhur me KPMSHCK);
- Mungesa e pozitive të nevojshme në kuadër të prokurorive në veçanti pozitave si në vijim:
 - Bashkëpunëtorë Profesional;
 - Zyrtarë Ligjor;
 - Zyrtarë për komunikim me publikun;
 - Personel administrative teknik (përfshirë sigurimin).
- Avancimi në karrierë i stafit administrativ (procedurat komplekse);
- Mungesa e disa pozitive në sekretariat dhe NjShPP me qëllim të zbatimit të mandatit në ofrimin e shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit.
- Ndërtimi i kapaciteteve për implementimin e SMIL në prokurori;
- Mungesa e trajnimeve adekuate për stafin administrativ të prokurorive dhe Këshillit;
- Mungesa e hapësirave të punës për stafin e sekretariatit dhe Njësitit të Performancës;
- Sistemi i vlerësimit të performancës së personelit;
- Mungesa e resurseve për ofrimin e sigurisë së nevojshme;
- Shpërblimi jo adekuat për një numër të pozitive të personelit administrativ;
- Sistemi aktual i administrimit dhe llogaridhënies;

